



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2021:236739

Datë: 15.02.2023

Numri i dokumentit: 03981707

PPP.nr.1098/2020

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Përpaim Zeka, në çështjen juridike përbarimore të kreditorit Kompania Rajonale Ujësjiellësi “Prishtina” Sh. A, me seli në Prishtinë, rruga “...” nr....., kundër debitorit H. S., me adresë në Prishtinë, rruga “...”, duke vendosur lidhur me propozimin për kthim në gjendjen e mëparshme dhe prapësimin e ushtruar nga debitori kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.274/2019, të datës 28.06.2019, të lejuar nga Zyra Përbarimore e Përbaruesit Privat për territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, D. G., jashtë seancës, me datë 14.02.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET propozimi për kthim në gjendjen e mëparshme i debitorit H. S., me adresë në Prishtinë, rruga “...”, LEJOHET kthimi në gjendjen e mëparshme, për shkak të lëshimit të afatit për parashtrimin e prapësimin.

II. Aprovohet pjesërisht si i bazuar, prapësimi i debitorit të përbarimit: H. S., me adresë në Prishtinë, rruga “...”, dhe shfuqizohet urdhëri mbi caktimin e përbarimit P.nr.274/2019 të datës 28.06.2019, të përbaruesit privat D. G. si organ përbarues, për shumën prej 1,160.00€ të kërkesës objekt i përbarimit.

III. Refuzohet si i pabazuar, prapësimi i debitorit të përbarimit: H. S., me adresë në Prishtinë, rruga “...”, sa i përket kërkesës objekt i përbarimit në shumën prej 263.88€,

dhe për këtë shumë urdhëri mbi caktimin e përmbarimit P.nr.274/2019 të datës 28.06.2019, mbetet në fuqi.

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat i emëruar për territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, D. G., duke vepruar sipas propozimit të kreditorit ka lëshuar urdhër me të cilin ka lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm- Kartela Financiare e Konsumatorit të lëshuar nga kreditori, Kompania Rajonale Ujësjetësi “Prishtina” Sh. A., e cila sipas nenit 21 të LPP-së paraqet bazë juridike për caktimin e përmbarimit, ndërsa në bazë të nenit 29 par. 1 pika 1.2 të këtij ligji janë dokumente të besueshme.

Debitori ka parashtruar kërkesë për kthim në gjendjen e mëparshme, me arsyetimin se debitori e mohon ta ketë pranuar lëndën në fjalë ndonjëherë dhe se e njëjta nuk dihet se nga kush është (pranuar) nënshkruar kjo sepse nga fletë kthese e cila gjendet në shkresat e lëndës, e cila ju vë në disponim për shiqim nga ana e përmbaruesit, debitorit, shihet qartë se data e pranimit të lëndës është e nënshkruar me një stilolaps tjetër, nënshkrimi me një stilolaps tjetër si dhe emri i debitorit po ashtu me një tjetër, andaj mbi bazën e një fletë kthese të tillë nuk mund të vërtetohet dhe të konstatohet se e njëjta është pranuar nga ana e personit konkret, në këtë rast debitorit, sepse një reagim të tillë do ta kishte në momentin e pranimit të një propozimi të tillë. Andaj, mbi këtë bazë dhe konform nenit 130 të LPK-së, ka kërkuar nga gjykata që të lejoj propozimin për kthim në gjendjen e mëparshme.

Gjykata me rastin e shqyrtimit të shkresave të lëndës vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi meqenëse ekziston arsyetimi për lëshimin e afatit për parashtrimin e prapësimit pasi që në nenin 110 të LPK-së është e rregulluar mënyra e dorëzimit të shkresave. Në paragrafin 1 të këtij neni është paraparë se padia, përgjigjja në padi, letërthirrja për në seancë, urdhërpagesa, aktgjykimi dhe aktvendimi, kundër të cilit lejohet ankimi i veçantë, mjeti i goditjes së vendimit, i dorëzohet personalisht palës, gjegjësisht përfaqësuesit ligjor apo përfaqësuesit me prokurë të saj..., ndërsa paragrafin

2 është përcaktuar se në qoftë së personi të cilit duhet dorëzuar personalisht shkresa nuk gjendet atje ku duhet bërë dorëzimi, dorëzuesi do të njoftohet se kur dhe ku do të mund ta gjejë këtë person dhe do t'ia lejë ndonjë personi të theksuar në nenin 111 paragrafi 1 dhe 2 të këtij ligji njoftimin me shkrim që për marrjen e shkresës të jetë në ditën dhe në orën e caktuar në banesën e vet, përkatësisht në vendin e vet të punës. Siç shihet në shkresat e lëndës, debitori propozimin për përmbarrim si dhe urdhrin për lejimin e përmbarrimit nuk e ka pranuar personalisht, pasi që nga fletë kthesa shihet qartë se e njëjta ka ndërhyrje në datën kur është pranuar propozimi dhe urdhëri, si dhe nënshkrimi në fletë kthesë nuk përkon me nënshkrimin të cilin e ka bërë debitori në prapësim. Sipas të cekurave më lartë e në kuptim të nenit 129 dhe 130 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, me të cilën gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Gjykata, pas shqyrtimit të pretendimeve në prapësim të debitorit të përmbarrimit dhe analizimit të shkresave të lëndës, ka gjetur se prapësimi i debitorit të përmbarrimit duhet të aprovohet pjesërisht si i bazuar dhe ka vendosur si në pikën II të dispozitivit, pas konstatimit se në këtë pjesë borxhi i kërkuar të realizohet me detyrim është parashkruar, për faktin se kreditori i përmbarrimit propozimin për përmbarrim e ka paraqitur me datë 28.06.2019, ndërsa sipas nenit 360.1 të LMD-së është rregulluar se: “kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake” parashkruhen pas kalimit të një viti, ndërsa, sipas paragrafit 2 të njëjtit neni është rregulluar se: “afati i parashkrimit rrjedh nga fundi i vitit në të cilin arrin kërkesa për pagesë”. Sipas par.2 të LMD-së, rrjedhimisht kreditori e ka humbur të drejtën për të kërkuar realizimin me detyrim të kërkesës së arritur për pagesë para datë 31.12.2017 në shumën prej 1,160.00€, dhe se i njëjti nuk ka afuara asnjë provë-dokument që do të ndikonte që gjykata të vendos ndryshe nga ajo që ka vendosur në dispozitivin e këtij aktvendimi.

Kjo edhe sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës Supreme të Kosovës të krijuar me aktgjykimin Rev.nr.148/2012 të dt:09.09.2013, me të cilin është sqaruar situata se: “borxhi për shpenzimin e energjisë elektrike është borxh periodik meqë i njëjti arrinë pas përfundimit të çdo muaji, dhe afati 1 vjeçar i paraparë në nenin 378 npar.1 pika 1 të LMD

për parashkrim rrjedh për secilin muaj pas momentit të përfundimit të atij muaji, që do të thotë se parashkrimi llogaritet për secilin muaj në mënyrë të veçantë.

Si në pikën III të dispozitivit, gjykata vendosi pasi pretendimet në prapësim të debitorit të përbarimit, i ka vlerësuar si të paqëndrueshme dhe të pabazuara në ligj, për arsye se nuk ka ofruar asnjë provë në mbështetje të pretendimeve të tij siç është paraparë me nenin 69 par. 4 të LPP-së, rrjedhimisht nuk janë përmbushur asnjë nga kushtet ligjore për anulimin e urdhërit mbi caktimin e përbarimit, apo shtyrjen e zbatimit të përbarimit, të përcaktuara me dispozitat e nenit 61 par 1 pika 1 dhe nenit 71 par 1, pika 1 deri në 12 të Ligjit për Procedurën Përbarimore (Ligji nr. 04/L-139), të Republikës së Kosovës.

Nga të cekurat si më lartë e në bazë të nenit 73 të Ligjit për Procedurën Përbarimore, kjo gjykatë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm

PPP.nr.1098/2020, datë 14.02.2023

Gjyqtari

Përparim Zeka

KËSHILLA JURIDIKE

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjti, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në kopje të mjftueshme për gjykatën dhe palën kundërshtar.